



Pranuar / Dorezuar Pritshëm/Prodato Received/Delivered	31.08	3	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot Dr Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHUK	5906/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.933/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi- Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.933/2023 të datës 07.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.08.2023

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër me numër A.nr.933/2023 e datës 07.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën e punës "Mbikëqyrës i Lartë", më datë 08.05.2023 ka kërkuar pushimin vjetor prej 27 dite pune të vitit 2022, ku Zëvendës Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Prizren ankuesit ka aprovuar 10 dite pune apo 84 ore. Tutje ankuesi me datën 22.06.2023 prapë ka parashtruar kërkesë për pushimin vjetor te pa shfrytëzuar për vitin 2022 ku ka kërkuar gjithsej 17 dite pune ndërsa te njëjtit i janë aprovuar vetëm 7 dite apo 60 or, ku ankuesit i kane mbetur edhe 10 dite pune te pa shfrytëzuar te pushimit vjetore për vitin 2022.

Ankuesi me datën 26.06.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 858 pranë Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datën 04.07.2023 ka marr vendim me te cilin është shpallur jo kompetent lidhur me ankesën e ankuesit.

Kundër vendimit të datës 04.07.2023 ankuesi me datën 07.07.2023 ka parashtruar ankese pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimore se ankuesit duhet ti lejohet shfrytëzimi i pushimit vjetor i mbetur nga viti 2022.

Me Vendimin me numër të protokollit 5731/2023 të datës 21.08.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.933/2023 të datës 07.07.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5093/2023 të datës 07.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e datës 04.07.2023 të Komisionit për rizgjedhjen e kontesteve dhe ankesave; Ankesën me numër të protokollit 858 të datës 26.06.2023 drejtuar nga ankuesi në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe ankesave; Emalin e datës 21.06.2023 të drejtuar D. Bajramaj; Emalin e datës 20.06.2023 të D. Bajramaj drejtuar Sh. Kamberaj; Emalin e datës 16.06.2023 të Sh. Kamberaj drejtuar Z. Bajramaj; Formularin për pushimin vjetor të datës 21.06.2023; Formularin për pushimin vjetor të datës 08.05.2023; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 12.07.2023; Emalin e datës 29.08.2023 të Sh. Kamberaj drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 05.05.2023 të A. Demiri drejtuar L. Guhelli; Emalin e datës 05.05.2023 të L. Guhelli drejtuar A. Demiri; Kërkesën për përgjigjen në ankese me numër të protokollit 933/2023 të datës 24.07.2023; Akt emërimin në shenjen A.E.Nr.170/2023 të datës 05.05.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës "Mbikëqyrës i Lartë": Vendimin e datës 19.03.2021 për themelimin e ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Emalin e datës 17.07.2023 të A. Demiri drejtuar XH. Isufi; Emalin e datës 14.07.2023 të A. Morina drejtuar A. Demiri; Vendimin me numër të protokollit 5731/2023 të datës 21.08.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës në mënyrë të kundërligjshme është shpallë jo kompetent për shqyrtimin e ankesës, po ashtu se sipas kërkesës për pushimin vjetor të datës 22.06.2023 ku ka kërkuar që ti aprovohen 17 ditët e mbetura nga viti 2022 ndërsa ankuesit ju janë aprovuar vetëm 7 dite.

Lidhur me pretendimin ankimore të ankuesit se Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 08KA/2 të datës 04.07.2023 në mënyrë të kundërligjshme është shpallur jo kompetent për shqyrtimin e ankesës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi në bazë të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, ka statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton se: "2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe

nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”, rrjedhimisht Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenit 24 paragrafi 3 është përcaktuar se: “Nëpunësit civil kanë të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligj...”, mbi këtë bazë meqenëse ankuesi ka statusin e nëpunësit civil nuk mund të parashtroj ankesë në Komisionin për Ankesa, si rezultat i kësaj Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 08KA/2 të datës 04.07.2023 ka vepruar në pajtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimet e ankuesit se nuk i janë aprovuar ditët e pushimit vjetor për vitin 2022 sipas kërkesës së datës 22.06.2023 për 17 ditët ndërsa ankuesit ju janë aprovuar vetëm 7 ditë, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 18 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar se: “Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës”, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 37 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili ka përcaktuar se: “5. Pushimi vjetor mund të shfrytëzohet në dy (2) apo më shumë pjesë, në marrëveshje me punëdhënësin. 6. Në qoftë se i punësuar i shfrytëzon në dy apo me shume pjesë pushimin vjetor, pjesa kryesore duhet të shfrytëzohet për së paku dhjetë (10) ditë pune të pandërprera gjatë një (1) vitit kalendarik. Pjesa tjetër e pushimit të pashfrytëzuar duhet të shfrytëzohet jo më vonë se 30 qershor të vitit të ardhshëm kalendarik”, dhe nenit 11 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, është përcaktuar se: “4. Në qoftë se zyrtari publik e shfrytëzon në dy (2) apo me shume pjesë pushimin vjetor, pjesa kryesore duhet të shfrytëzohet për së paku dhjetë (10) ditë pune të pandërprera gjatë një (1) vitit kalendarik. 5. Pjesa tjetër e pushimit të pashfrytëzuar duhet të shfrytëzohet jo më vonë se deri me 30 qershor të vitit të ardhshëm kalendarik.

Sipas provave të lëndës, ankuesi pushim vjetor të vitit 2022 ka pasur gjithsej 27 ditë të pashfrytëzuar, ndërsa në bazë të kërkesës së datës 08.05.2023 ankuesit i janë aprovuar dhjetë (10) ditë të pushimit vjetor të vitit 2022 të cilët i ka shfrytëzuar nga data 08.05.2023 deri më datë 22.05.2023, ndërsa ankuesi në muajin qershor 2023 konkretisht më datë 21.06.2023 ka kërkuar 17 ditë të pushimit vjetor të vitit 2022, ndërsa i janë aprovuar vetëm shtatë (7) ditë dhe atë nga data 22.06.2023 deri më datë 30.06.2023. Rrjedhimisht referuar kuadrit ligjor të lartcekura, si dhe referuar provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë konstatimin si më lartë dhe gjendjen faktike dhe bazën juridike, konstaton se pushimi vjetor i vitit 2022 nga ankuesi është dashur që të shfrytëzohet deri më datë 30 qershor të vitit 2023, ndërsa nisur nga kërkesa e datës 21.06.2023 nuk mund të shfrytëzohen 17 ditë të pushimit vjetor të vitit 2022, ngase nuk korrespondon me periudhën kohore të shfrytëzimit të pushimit vjetor të përcaktuar me dispozitat e lartcekura dhe me ditët e kërkuara pasi që nga data e kërkesës (21.06.2023) deri më datë 30 qershor janë vetëm shtatë (7) ditë pune dhe pas datës 30 qershor 2023 nuk lejohet shfrytëzimi i pushimit vjetor të vitit paraprak, kështu që nisur nga këto konstatime pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.933/2023


Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit 
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

